



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**  
**DREJTORIA E ZHVILLIMIT BUJQËSOR**

Nr. 138 Prot.

Patos, më 13.03.2024

**MIRATOHET**  
**KRYETARI**  
**Fation Duro**

**PROJEKT-VENDIM**  
Nr. 22, datë 13.03.2024

**PËR MIRATIM TË PLANIT TË MASAVE PËR**  
**MBROJTJEN E PYJEVE NGA ZJARRI**

**KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS**

Në mbështetje të nenit 30, pikat 4, 5 dhe 6 të ligjit nr. 57 datë 30.04.2020 “Për Pyjet”, nenit 27, pika 5 të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, VKM-së nr. 1080 datë 22.12.2010 “Për rregullat dhe parandalimin e shuarjes së zjarreve në pyjet dhe kullota” si dhe krijimin e skuadrave vullnetare për shuarjen e zjarreve, për të mbrojtur pyjet nga zjarri kërkohet;

1. Miratimin e “**Planit të Masave për Mbrojtjen e Pyjeve nga Zjarri**”, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij projekt-vendimi.
2. Ekzkutivi brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij projekt-vendimi të miratojë planin e veprimit.
3. Pas miratimit të këtij projekt-vendimi ngarkohet për zbatim, Drejtoria e Zhvillimit Bujqësor, Sektori i Emergjencave Civile, Policia Bashkiake, Sektori MZSH-së.

Përgj/Sek Juridik  
**Nurkë Hazizaj**

Specialist i Pyjeve  
**Xhemil Begaj**

Drejtor i Bujqësisë  
**Orges Gollosi**

Kryeinspektor i MZSH-së  
**Alket Halimi**

Përgj/Sek të Emergjencave Civile  
**Arben Shpërdheja**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**  
**DREJTORIA E ZHVILLIMIT BUJQËSOR**

Nr. 738 / Prot.  
1

Patos, më 13.03.2024



**MIRATOHET**  
**KRYETARI**  
**Fation Duro**

**PLAN MASASH**  
**PËR MBROJTJEN E PYJEVE NGA ZJARRI**  
**2024**

Bazuar në ligjin nr. 115 datë 31.07.2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të Njësiave të Vetëqeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”, bashkia Patos përbëhet nga 3 Njësi Administrative, të cilat janë: Patos, Zharrëz dhe Ruzhdie. Mbështetur në nenin nr. 27 të ligjit nr 139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, bashkia Patos është përgjegjëse për administrimin e fondit pyjor dhe kullor sipas legjislacionit në fuqi.

Tabela më poshtë jep të dhënat mbi sipërfaqet pyjore për secilën Njësi Administrative të bashkisë Patos.

Nr.	Njësi administrative	Sip totale (ha)	Pyje/kullota (ha)	Lloji drusor
1	Ruzhdie	651,33	633	Pishë, Lis dhe Shkurre
2	Zharrëz	31,42	12	Plep, Akacie dhe Ekualipt.

Sipërfaqja e kësaj pasurie, rëndësia e saj por edhe shpërndarja e madhe bën që ti kushtohet një rëndësi e madhe administrimit dhe mbrojtjes nga zjarri.

Ky plan ka për qëllim të sigurojë gatishmërinë dhe reagimin efikas ndaj zjarreve për të mbrojtur pyjet dhe sigurinë e komunitetit.

Plani i masave për mbrojtjen e pyjeve nga zjarri përfshin:

- Strategjitë e mbrojtjes:** Hartimi i strategjive specifike për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve, duke përfshirë punën me dhënie dore në pastrimin e zonave dhe hartimin e barriereve.
- Hartimin e hartave të rrezikut:** Identifikimi i zonave të rrezikuara dhe krijimi i hartave që përcaktojnë zonat prioritare për masat e mbrojtjes.

3. **Pjesëmarrja e komunitetit:** Informimi dhe pjesëmarrja e komunitetit në masat e mbrojtjes, duke inkurajuar bashkëpunimin dhe ndihmën reciproke.
4. **Monitorimi dhe paralajmërimi i shpejtë:** Krijimi i sistemeve të monitorimit dhe paralajmërimit të shpejt, duke përfshirë sensorë dhe sisteme të avancuara të komunikimit.
5. **Gatishmëria dhe trajnimet:** Trajnimet dhe ushtrime të rregullta për personelin dhe komunitetin në përgjigje ndaj zjarreve, duke përfshirë evakuimin dhe përdorimin e pajisjeve të sigurisë.
6. **Bashkëpunimi me autoritetet:** Ndërtimi i lidhjeve të ngushta dhe bashkëpunimi me autoritetet lokale dhe të tjera për koordinim efikas dhe të shpejtë në situata të emergjencave.
7. **Përdorimi i teknologjisë:** Përdorimi i teknologjisë për mbrojtje të avancuar, përfshirë monitorimin nga distanca dhe ndërhyrjen me pajisje të avancuara për zbulimin e zjarreve.

## SHKAQET E RËNIES SË ZJARREVE

Arsyet e rënies së zjarreve janë nga më të ndryshmet por në bazë të përvojave dhe njohurive të deritanishme në 99% të rasteve të shfaqjes së këtyre zjarreve si shkak paraqitet njeriu (direkt ose indirekt). Rrufeja apo vetëndezja e pyjeve kap vetëm 1% të rasteve. Rënia e zjarreve në pyje/kullota ku shkaktar është njeriu ndodh nga pakujdesia, padituria, piromania si sëmundje apo qëllim i pastër. Zjarret e shkaktuara nga pakujdesia apo padituria, përfshijnë kryesisht zjarret e shkaktuara nga njerëzit që punojnë në pyje apo kullota të cilët kryejnë punime operacionale në këto zona. Këto zjarre ndodhin zakonisht në pranverën e herëshme kur vegjetacioni baror nga viti i kaluar është i thatë dhe vegjetacioni i ri akoma nuk ka filluar. Këtu si shkaktarë të zjarreve janë mbledhësit e frutave pyjore, bimëve medicinale, gjuetarët, fermerët apo edhe turistët. Zjarret e qëllimshme bëhen me qëllim që të zgjerojnë tokën e punueshme apo kullotat, ku njeriu ndez zjarrin pa llogaritur pasojat. Motivet e këtyre zjarreve janë nga më të ndryshmet, ato mund të jenë edhe për përfitim ekonomik, për përfitim dru të lirë për dru zjarri apo ndërtim, për të mbuluar prerjet ilegale etj.

## KLASIFIKIMI I ZJARREVE NË PYJE/KULLOTA

Sipas llojeve të zjarreve në pyje mund ti specifikojmë në:

- Zjarr nëntokësor ose nënsipërfaqësor.
- Zjarr sipërfaqësor ose pranë nëntokës.
- Zjarr në kurorat e drurëve.
- Zjarr i përgjithshëm ose i kombinuar.

Më të përhapur tek ne janë tre rastet e fundit:

Zjarri sipërfaqësor është zjarri në të cilin djegia aktive zhvillohet në sipërfaqe të tokës dhe digjet përgjithësisht bimësi pranë tokës në sipërfaqe si bar, filiza, shkurre etj. Në varësi të kushteve dhe pranisë së erës flakët e zjarrit mund të arrijnë deri në 2 m. Në rajonet e rafshëta djegia intensive zakonisht ndjek buzët e zjarrit, ndërsa në zonat

kodrinore-malore ajo zhvillohet në ballin e zjarrit. Shpejtësia e përhapjes së këtij zjarri (pa erë të fortë) mund të arrijë deri në 2.5 km/h.

Zjarri në kurorat e drurëve është një zjarr që ndodh vetëm në kulm apo kurorë të drurëve. Ky lloj zjarri mund të jetë fillesa e një zjarri të kombinuar për shkak të kushteve specifike të djegies gjatë këtyre zjarreve, shpejtësia e përhapjes arrin deri në 20 km/h.

Zjarri i përgjithshëm ose i kombinuar përfshin djegien sipërfaqësore si edhe si edhe atë të kurorave. Shkalla e përhapjes së këtyre zjarreve në vartësi të terrenit, llojit të drurëve si edhe shpejtësisë së erës mund të arrijë deri në 20 km /h. Vetë përhapja e zjarrit zakonisht zhvillohet në tre faza: faza fillestare, kërcënimi i zjarrit dhe faza e qetësimit. Zjarrfikësit dhe jo vetëm, duhet të njohin mirë mënyrën dhe fazat e përhapjes së zjarrit në mënyrë që të shmangin rrezikun në momentin që ndodh kërcimi i zjarrit dhe kështu vihen nën kërcënim jetët e tyre.

### **FAKTORËT QË NDIKOJNË NË RRITJEN E RREZIKUT PËR SHFAQJEN DHE ZHVILLIMIN E ZJARREVE NË PYJE.**

Më të rëndësishmit janë.

- Lloji i bimësisë
- Topografia
- Stina vjetore
- Karakteristikat klimaterike
- Komunikacioni

Lloji i bimësisë është një nga faktorët kryesorë që ndikojnë në shkallën e rrezikut nga zjarret. Kështu pyjet halorë ndizen më lehtë se ato gjetherënës. Drurët dritëdashës janë më të rrezikuar kjo për shkak se përbërja e pyllit me këto lloje drurësh është më e rrallë. Kështu llojet e bimëve që ndizen lehtë dhe e mbështesin fuqimisht djegien quhen specie bimore “profibe” (pishë, bredh etj).

Topografia apo relievi i terrenit, së bashku me llojin e tokës luan një rol të rëndësishëm në shkallën e ndezshmërisë të materialit djegës. Në përgjithësi në terrenet të cilët kanë relief të fortë me orientim nga jugu është lehtësisht më i ndezshëm se ai i orientuar nga veriu. Kjo edhe për vetë faktin e bimësisë që rritet në të.

Stinët me karakteristikat e tyre ndikojnë në ndezshmërinë e pyjeve. Vera me temperatura të larta të ajrit (tek ne rreth 40°) dhe periudha të gjata pa shi e rritin shkallën e ndezshmërisë në pyje/kullota. Në këtë periudhë bari thahet, lagështia e tokës zvogëlohet në mënyrë drastike dhe përbën rrezik për zjarr. Kështu kjo periudhë quhet “periudhë kritike e vitit për shfaqjen e zjarreve në hapësirë të hapur”. Edhe gjatë periudhës së dimrit për shkak të temperaturave shumë të ulta kryesisht kur dimri është i thatë, për shkak të lagështisë së ulët të tokës, materiali djegës mund të ndizet lehtësisht.

Klima në rajonin tonë si një klimë mesdhetare është favorizuesë për zjarret si në hapësira të hapura ashtu edhe në zonat e pyjeve.

Komunikacioni. Ashtu sic kemi vënë re, shkak kryesor i zjarreve (me apo pa qëllim) është njeriu. Hapja e rrugëve në zonat e pyjeve apo në afërsi të tyre përdorimi për piknik,

rekreacion mbledhjen e produkteve të ndërmjetme pyjore përbën rrezik për zjarr. Por nga ana tjetër pavarësisht efektit negativ, është edhe ai pozitiv i cili mundëson një kontroll më të mirë të zonës apo qasje më të shpejtë të zjarrfikseve dhe automjeteve në rast zjarri.

## **MASAT PËR PARANDALIMIN E ZJARREVE NË PYJE E KULLOTA**

Të gjitha masat që meren për parandalimin e zjarreve sipas kohës kur ndërmerren dhe me çfarë qëllimi, ndahen në:

- a. Masa preventive
- b. Masa përgatitore
- c. Masa direkte

### **MASA PREVENTIVE**

Janë masa mbrojtje kundër zjarreve që merren vazhdimisht gjatë vitit. Kjo për shkak se njeriu është shkaktar i tyre në 99% të rasteve edhe këto masa janë të përqëndruara plotësisht ndaj njeriut. Qëllimi final është të parandalohet shkaktimi i zjarreve dhe të zvogëlohet numri i këtyre zjarreve. Në këtë kuadër këto masa janë:

- **Ligjore**, mbrojtja e pyjeve rregullohet me ligje dhe akte nënligjore ku mbrojtja e tyre është përgjegjësi e të gjithëve dhe pronarëve si dhe subjekteve që i menaxhojnë ato.
- **Edukative**, këto janë masat të cilat në vetvete përfshijnë edukimin e njerzve dhe përdoren për të gjitha grupmoshat. Mënyrat janë nga më të ndryshmet që nga mësimet në librat shkollore, leksione të hapura për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret, përdorimi i revistave, fletëpalosjeve etj.
- **Informative**, qëllimi i tyre është për të paralajmëruar dhe informuar njerëzit për rreziqet nga paraqitja e zjarreve në pyje si dhe për të informuar se si duhet të sillemi gjatë qëndrimit në pyll, kjo masë kombinohet edhe me atë edukative.

### **MASA PREGATITORE**

Duke patur parasysh që masat preventive nuk e zgjidhin plotësisht problemin e mbrojtjes së pyjeve nga zjarret është e domosdoshme marrja e masave përgatitore. Këto masa kanë një natyrë të përhershme gjatë gjithë vitit dhe përfshihen:

- a. Krijimi i strukturës vrojtim-sinjalizim.
- b. Trasferimi i informacionit mbi zjarrin.
- c. Rrugë kalimet e mundshme në rast zjarri në masivin pyjor Siqecë-Drenie.
  - 1. Patos-Ruzhdië-Gjinoqarë.
  - 2. Patos-Siqecë-Drenie.
  - 3. Patos- Visokë-Lapulec- Lofkënd-Drenie
  - 4. Patos-Kasnicë.
  - 5. Patos-Zharrëz-Belinë-Argjinaturë.
- d. Organizimi i zjarrëfiksive dhe vullentarëve.

- e. Ndërtimi kanaleve kundra zjarrit.
- f. Përgatitja e planit operativ vjetor për mbrojtjen nga zjarri.

## **MASAT DIREKTE**

Pavarësisht nga masat më të mira preventive të mara, zjarret përsëri ndodhin. Për këtë arsye nevojiten masa direkte. Këto janë masa të cilat ndërmerren gjatë kohëzgjatjes së zjarrit dhe synojnë lokalizimin dhe shuarjen e tij. Për të lokalizuar dhe shuar një zjarr është e nevojshme të largohet një nga elementët nga i ashtuquajtimi trekëndëshi i Osborn-it përkatësisht materiali djegës, burimi i nxehtësisë, oksigjeni. Sipas asaj secili material ose mjet përdoret për këtë qëllim, metoda e shuarjes ndahen në:

1. Shuarje e zjarrit me tokë, metoda e vjetër e përdorur për këtë qëllim ku materiali tokës përdoret si izolator, pra largon elementin oksigjen nga materiali djegës. Toka gjithashtu vepron si një izolantë i nxehtësisë, përkatësisht energjia termike për djegjen e drurit.
2. Shuarja e zjarrit me ujë, është metodë tradicionale në shuarjen e zjarreve. Veprimi i ujit në procesin e shuarjes është i shumfishtë.
3. Luftimi i zjarrit me zjarrë megjithëse duket konfuz, kjo metodë është efektive po mbart në vetëvete rrezik dhe kërkon persona të trajnuar dhe me përvojë. Në varësi të taktikës për lokalizimin dhe shuarjen e zjarrit në një distancë të caktuar nga zjarri ndizet një “zjarr i kontrolluar” që mund të lëvizë në drejtim të kundërt ose në të njëjtën me drejtimin e zjarrit i cili djegë materialin para frontit të zjarrit, kur zjarri arrin në atë sipërfaqe, nuk ka çfarë të djeg dhe zjarri shuhet.
4. Shuarja e zjarrit nga ajri nëpërmjet aeroplanëve është përdorur për herë të parë në vitin 1930. Në përgjithësi kjo është një metodë uji ose kimikatesh por për shkak të specifikës është veçuar si metodë e veçantë.
5. Shuarja e zjarrit me kimikate në këtë rast përdoren kimikate të ndryshme. Kjo metodë alternohet me atë të ujit sepse në përgjithësi keto kimikate shpërbehen nëpërmjet ujit.
6. Shuarje e zjarrit me eksploziv përdoret kryesisht si metodë ndihmëse. Kryesisht për të rrëzuar pemë, gjermim kanalesh, krijim pengesash etj. Në rastet e shpërthimeve krijohet “re e pluhurit” e cila ul përqindjen e oksigjenit në ajër rrjedhimisht ulë intesitetin ose shuhet plotësisht.

## **VEPRIMET KRYESORE GJATË ZBULIMIT TË ZJARRIT NË PYJE/KULLOTA.**

Detyrë qytetare e çdo individi, në rast se zbulon zjarr në pyll/kullotë, është që të njoftojë sa më shpejt të jetë e mundur institucionet përgjegjëse. Nga shpejtësia e informimit, saktësia dhe përmajtja varet suksesi i aksionit të shuarjes së zjarrit. Hapat që duhet të ndërmerren janë:

1. Telefononi nr. 128 pa pagesë i Shërbimit Zjarrfikës.

2. Prezantoni veten me emër e mbiemër.
3. Tregoni se ku jeni (vendndodhjen e saktë).
  4. Tregoni vendndodhjen e zjarrit (duke dhënë pikat orientuese më të sakta, emrin e vendit, vendbanimit më të afërt apo objekte të njohura).
  5. Tregoni llojin e bimësisë që po digjet (dru, shkurre, bar etj).
  6. Nëse vëreni diçka të dyshimtë afër vatrës së zjarrit psh automjet mundohuni të shënoni targën apo ta mbani mend.
  7. Nëse vlerësoni se mund të shuani zjarrin me mjete rrethanore atëhere ndërhyini, në të kundërt largohuni në një distancë të sigurtë.
  8. Me qëllim që të kuptoheni me personin në telefon jeni të lutur të flisni qartë dhe ngadalë. Informacioni i dhënë në këtë mënyrë është i saktë dhe përmban të gjitha elementet e nevojshme, përcaktimi i vatrës së zjarrit, lloji i materialit djegës, nëse zjarri ka qënë i qëllimshëm etj.

#### **PLANI I MASAVE PËR PARANDALIMIN DHE MENAXHIMIN E ZJARREVE NË FONDIN PYJOR/KULLOSOR.**

Baza Ligjore:

1. Ligji nr. 115 datë 31.07.2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”,
2. Ligji nr. 139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
3. Ligji nr. 57 datë 30.04.2020 “Për Pyjet”
4. Ligji nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor” i ndryshuar.
5. Ligji nr. 10 431, datë 09.06. 2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, i ndryshuar.
6. Ligji nr. 152, datë 21.12. 2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”.
7. VKM-së nr. 1080, datë 22.12.2010 “Mbi rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota”.
8. Ligji nr. 45 datë 18.07.2019 “Për mbrojtjen civile”.

**Bashkia Patos me strukturat e saj, Njësitë Administrative, Drejtorinë e Zhvillimit Bujqësor në zbatim të dispozitave ligjore si më sipër, për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në fondin pyjor/kullor në administrim të saj parashikon marrjen e masave organizative si më poshtë:**

1. Në rastet e zjarreve në pyje/kullota në territorin e bashkisë Patos ngrihet dhe funksionon sipas urdhërit të Kryetarit të Bashkisë, shtabi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi i cili drejton dhe organizon gjithë veprimtarinë për “Organizimin e ndërhyrjes në shuarjen e zjarrit dhe shpëtimin”.
2. Pranë Drejtorisë së Zhvillimit Bujqësor është organizuar sistemi i vrojtimit-sinjalizimit me anë të strukturës së Vrojtuesve.

3. Të gjitha Njësitë Administrative të bashkisë Patos të organizojnë/riorganizojnë “Shërbimin vullnetar të mbrojtjes nga zjarri”. Skuadra e “Shërbimit vullnetar të mbrojtjes nga zjarri” do të jenë strukturat e para që së bashku me strukturat e tjera pyjore do të mbajnë nën kontroll zjarrin deri në mbërritjen e forcave dhe mjeteve që do të organizohen nga Shtabi i Bashkisë Patos.

Afati i realizimit: Prill 2024

4. Struktura Njësitë Vullnetare për shuarje zjarri, nëpërmjet Sektorit të Emergjencave Civile, do të trajnohen dhe kualifikohen për mënyrën e shuarjes së zjarrit në pyje/kullota.

Afati i realizimit: Maj 2024

5. Bashkia Patos nëpërmjet strukturave të saj, Drejtorisë së Zhvillimit Bujqësor, Sektorit të Emergjencave Civile dhe MZSH-së, do të organizojë biseda me komunitetin e zonave Pyjore, nxënësve të shkollave në këto zona mbi sensibilizimin e opinionit për rëndësinë e mbrojtjes së pyjeve/kullotave.

Afati i realizimit: Gjatë gjithë vitit 2024

6. Bashkia Patos nëpërmjet Drejtorisë së Zhvillimit Bujqësor, do të realizojë Hartën e Zonave të Rrezikuara nga Zjarri për Pyjet/Kullotat në territorin e Bashkisë Patos. Kjo Hartë do të bëhet publike në të tre Njësitë Administrative të cilat kanë zonë pyjore të rrezikuar, shkolla si edhe ambiente të tjera publike. Kjo hartë do të vihet në dispozicion edhe Sektorit të Emergjencave Civile dhe MZSH-së.

Afati i realizimit: Maj 2024.

7. Punonjësit e Drejtorisë së Zhvillimit Bujqësor, detyrohen të zhvillojnë takime me Administratorët e NJ.A., komunitetin, barinjët në kullota, subjekte të tjera që veprojnë në mjedisin pyjor /kulloror më qëllim ndërgjegjësimin për rëndësinë e pyjeve/kullotave si edhe parandalimin e rënies së zjarreve.

Afati i realizimit: Gjatë gjithë vitit 2024.

8. Të gjitha strukturat e shërbimit pyjor gjatë periudhës së emergjencës (Maj-Tetor) të kenë të njohura në çdo moment lëvizjet e punonjësve. Për çdo lëvizje të lihet nr i telefonit celular dhe familjar.

Afati i realizimit: Maj-Tetor 2024.

9. Vrojtues/sinjalizues dhe punonjësit e shërbimit pyjor gjatë periudhës së emergjencës (Maj-Tetor) do të njoftojnë në Drejtorinë e Zhvillimit Bujqësor, 2 herë në ditë ora 8<sup>00</sup> dhe 18<sup>00</sup> mbi situatën në zonën e tyre. Për këto njoftime do të mbahet Libri i Gatishmërisë.

Afati i realizimit: Maj-Tetor 2024.

10. Drejtoria e Zhvillimit Bujqësor çdo të hënë dorëzon pranë bashkisë Patos evidencën operative të situatës javore.

Afati i realizimit: Maj-Tetor 2024.

11. Në rastet e shfaqjes së zjarrit në zonë pyjore/kullosore, vrojtuesi/sinjalizuesi kryen veprimet si më poshtë:

**a.** Njofton menjëherë në numrin e telefonit 128 Shërbimin Zjarrfikës dhe nr. 126 ose 129 të Policisë së Shtetit ku prezanton veten me emër e mbiemër, tregon se ku jeni (vendndodhjen e saktë), tregon vendndodhjen e zjarrit (duke dhënë pikat orjentuese me ta sakta, emrin e vendit, vendbanimit më të afërt apo objekte te njohura), tregoni llojin e bimësisë që po digjet (dru, shkurre, bar etj).

**b.** Njofton Administratorin e NJ.A. ku ndodhet vatra e zjarrit.

**c.** Nëse vlerësoni se mund të shuani zjarrin me mjete rrethanore atëhere ndërhyini, në të kundërt largohuni në një distancë te sigurt.

- Në rastet e shfaqjes së zjarrit në zonë pyjore/kullosore pas marrjes së njoftimit nga vrojtuesi/sinjalizuesi, Administratori i NJ.A., kryen veprimet si më poshte:

**d.** Njofton Kryetarin e Bashkisë.

**e.** Njofton Strukturën Njësitë Vullnetare për shuarje zjarri e cila është ngritur dhe funksionon pranë NJ.A. në fjalë.

**f.** Të gjithë bashkë organizohen për shuarjen e zjarrit ose lokalizimin e tij deri në mbërritjen e forcave të specializuar të mbrojtjes nga zjarri.

12. Shtabi për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi mblidhet në çdo kohë që shihet e arsyeshme nga Kryetari i saj. Në këto mbledhje do të analizojë gjendjen dhe do të përcaktojë masat në vijueshmëri në përputhje me situatat që mund të krijohen. Përgatit dhe publikon komunikatën dhe informacione të tjera të nevojshme në funksion të situatës për punën e bërë në mbrojtjen e Pyjeve dhe Kullotave nga zjarret.

13. Shtabi për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi në rastet e “zjarreve masive” apo “zjarreve me përmasa të mëdha” sipas situatës që krijohet, i kërkon Institucionit të Prefektit në pozicionin e kryetarit të Shtabit qëndror ndihmë për përballimin e situatës.

**Spec i Pyjeve**  
**Xhemil Begaj**



**Prgj Sek Pyje/Mjedis**  
**Blerina Laçi**



**Drejtori**  
**Orges Gollosi**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA PATOS**  
**DREJTORIA E ZHVILLIMIT BUJQËSOR**

Nr 138 / Prot.  
2

Patos, më 13.03 . 2024

**RELACION**  
**PËR**  
**MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE PËR MBROJTJEN E PYJEVE NGA**  
**ZJARRI**

**KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS**

Në mbështetje të nenit 30, pikat 4, 5 dhe 6 të ligjit nr.57, datë 30.02.2020 “Për Pyjet”, nenit 27, pika 5 të ligjit nr.139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, VKM-së nr. 1080, datë 22.12.2010 “Për rregullat dhe parandalimin e shuarjes së zjarreve në pyjet dhe kullota” si dhe krijimin e skuadrave vullnetare për shuarjen e zjarreve, paraqesim sot për miratim **“Planin e Masave për Mbrojtjen e Pyjeve nga Zjarri”**.

Ky plan ka për qëllim të sigurojë gatishmërinë dhe reagimin efikas ndaj zjarreve për të mbrojtur pyjet dhe sigurinë e komunitetit.

Plani përmban:

- Shkaqet kryesore të rënies së zjarrit në pyje.
  - Klasifikimin e zjarreve në pyje.
  - Faktorët që ndikojnë në rritjen e riskut për shfaqjen e zjarreve.
  - Masat për parandalimin e zjarreve në pyje.
  - Veprimet kryesore gjatë zbulimit të zjarrit në pyje.
  - Masat që do të zbatohen për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në fondin pyjor/kullosor
  - Krijimin e strukturave në qëndër dhe për çdo fshat (lagje), organizimin e vrojtimeve, sinjalizimeve për bashkinë Patos, nga pika më e lartë në lartësinë 545.8 m Cuka e Llasit si pikë kryesore dhe kuotën 506 m mbi nivelin e detit si pikë ndihmëse, në Ekonominë Pyjore Drenie, e cila është pika dominuese për gjithë territorin e bashkisë Patos;
  - Vendosjen e tabelave sensibilizuese “Mbroni Pyjet nga Zjarri”, në pikat kyçe dhe rrugë kalime të ndryshme;
  - Pastrimi i brezit mbrojtës me Ekualiptë në Ekonominë Pyjore “Lumi Seman 2”.
  - Organizimin e takimeve trajnuese me kryetarë të fshatrave dhe fermerë të Njësisë Administrative të cilët disponojnë prona në kufi me sipërfaqet pyjore, punëtorët që do të punojnë për mirëmbajtjen e pyjeve si dhe skuadrave zjarrfikëse.
- Nga hartimi dhe zbatimi i këtij plani synohet zvogëlimi i riskut në Ekonominë Pyjore të bashkisë Patos.

Përsa më sipër për përmbushjen e detyrimit ligjor dhe zbutjen e riskut të zjarreve në pyje  
kërkojmë prej Këshillit Bashkiak miratimin e këtij plani masash.

Specialisti Pyjeve

**Xhemil Begaj**



Përgjegjëse Sektori

**Blerina Laçi**



Drejtori

**Orges Golloshi**



KRYETARI

**Fation Duro**

